

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr. _____ Akt *2, 152*

V E N D I M

PER RREGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Sot me date *7.09.99*, une gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane *Anna Xeshe*,
si shqyrtova kerkesen dhe materialin e paraqitur nga Ministria e Ekonomise
Publike dhe Privatizimit per rregjistrimin e shoqerise tregtare "Albbaker" Tirane

KONSTATOVA SE :

Kerkuesi Ministria Ekonomise Publike dhe Privatizimit ka paraqitur kerkesen per
te rregjistruar si person juridik shoqerine ne formen e nje shoqerie anonime
"Albbaker" Tirane me kohezgjatje pa afat te caktuar, me aksioner te vetem
Ministrine Ekonomise Publike dhe Privatizimit, me kapital themeltar
2.174.641.000 leke i ndare ne 2.174.641 aksione, me vlere nominale 1000 leke,
me objekt veprimtarie;

- Shfrytezimi i vendburimeve te mineralit te bakrit, nxjerrje, pasurim dhe perpunim
i mineralit, prodhim dhe shitje i bakrit dhe nenprodukteve te tij.
- Shoqeria merr persiper ruajtjen e objekteve te saj konform legjislacionit ne fuqi.
Dokumentacioni i paraqitur, akti i themelimit, statuti, urdheri nr.21 date 1.02.1999,
i Ministririt te Ekonomise Publike dhe Privatizimit dhe kerkesa per miratim
eksperti jane te plota dhe te bazuara ne ligj dhe si te tilla duhet te pranohen.

PER KETO ARSYE :

Ne baze te Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite trgetare", si dhe nenit 33
ligjit Nr.7667, date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen
plotesuar ne te".


V E N D O S A :

Rregjistrimin si person juridik te shoqerise anonime "Albbaker" Tirane, me
kohezgjatje pa afat te caktuar me kapital themeltar 2.174.641.000 leke me aksioner
te vetem Ministrine e Ekonomise Publike dhe Privatizimit, me vlere nominale te
aksionit 1.000 leke dhe me objekt veprimtarie :

- Shfrytezimi i vendburimeve te mineralit te bakrit, nxjerrje, pasurim dhe perpunim
i mineralit, prodhim dhe shitje i bakrit dhe nenprodukteve te tij.
- Shoqeria merr persiper ruajtjen e objekteve te saj konform legjislacionit ne fuqi.
- Mehmet ZAÇE
- Aferdita BARETI
- Andon GRAZHDANI
- Zef LLESHI
- Sokol DACI
- Skender HASA

Kunder vendimit lejohet ankimi ne shkalle te dyte.

GJYQTARE



Anna Xeshe
[Signature]

AKT -THEMELIMI I SHOQERISE ANONIME

Ne Tirane, sot me date 9.0.2.1999, ne baze te Ligjit Nr.8237, date 1.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shtetore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr.1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr.8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr.1631, date 1.11.1996 dhe Ligjin Nr.8158, date 7.11.1996, Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit

VENDOSI:

1. Te krijoje shoqerine anonime "Albbaker" Tiranes Sh.A.
2. Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete :
 - Shfrytezimi i vendburimeve te mineralit te bakrit, nxjerrje, pasurim dhe perpunim i mineralit, prodhim dhe shitje i bakrit dhe nenprodukteve te tij.
 - Shoqeria merr persiper ruajtjen e objekteve te saj konform legjislacionit ne fuqi.
3. Shoqeria do te kete seline e saj ne Tirane dhe ajo mund te cele dege, filiale, agjensi dhe perfaqesi ne te gjithë teritorin e Republikës se Shqipërisë dhe me miratimin e organeve kopetente edhe jashte shtetit.
4. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 2.174.641.000 leke i ndare ne 2.174.641 aksione me vlere nominale 1000 leke.
5. Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj pa afat te caktuar.
6. Keshilli i pare mbikqyres perbehet nga :
 - Mehmet ZAÇE
 - Aferdita BARETI
 - Andon GRAZHDANI
 - Zef LLESHI
 - Sokol DACI
 - Skender HASA
7. Ndertimi, organizimi dhe funksionimi i shoqerise rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te statutit dhe ketij akti themelimi.
8. Shoqeria fillon veprimtarine me nenshkrimin dhe miratimin e dokumentave te saj themeluese.

